

ALBDESIGN PSP SH.P.K
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me Raportin e Audituesit të pavarur

Përmbajtja

	Faqe
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 - 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e vetëm të Shoqërisë Albdesign PSP shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albdesign PSP shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdohë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose te marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.




ILD 99 Audit shpk
Luan Kamberi
Partner

27 mars 2018

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	75,152,492	21,318,714
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	74,640,577	75,555,290
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	51,883,469	2,082,320
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	1,191,850	8,124,049
Inventari	8	1,554,073	220,170
Shpenzime të shtyra	9	2,795,303	6,459,343
Total aktive afatshkurtra		207,217,764	113,759,886
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	39,684,321	35,841,680
Pjesmarrje në njësi të tjera	11	25	
Total aktive afatgjata		39,684,346	35,841,680
Total aktive		246,902,110	149,601,566
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	250,567	141,376
Llogari të pagueshme tregtare	13	56,647,995	107,052,823
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	14	105,771,663	-
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara	15	35,753	34,659
Detyrime tatimore	16	4,117,258	2,025,081
Të ardhurat e shtyra		3,349,833	3,333,333
Të tjera detyrime	17	685,871	30,080
Total detyrime afatshkurtra		170,858,940	112,617,352
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj palëve e lidhura	18	2,985,840	2,985,840
Total detyrime afatgjata		2,985,840	2,985,840
Totali i detyrimeve		173,844,780	115,603,192
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	19	100,000	100,000
Rezerva ligjore		10,000	10,000
Rezerva të tjera		33,888,374	7,937,691
Fitimi i ushtrimit		39,058,956	25,950,683
Total kapitali		73,057,330	33,998,374
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		246,902,110	149,601,566

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	318,379,590	200,701,223
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	139,231	32,464
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(248,571,446)	(156,529,758)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	22	(233,387,761)	(131,353,347)
2) Të tjera shpenzime	23	(15,183,685)	(25,176,411)
Shpenzime të personelit	24	(14,018,333)	(12,204,197)
1) Paga dhe shpërblime		(12,066,927)	(10,528,958)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(1,951,406)	(1,675,239)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(9,225,509)	(1,426,598)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(55,500)	-
Shpenzime financiare	26	(142,931)	(3,535)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(150,863)	(1,713)
2) Shpenzime të tjera financiare		7,932	(1,822)
Fitimi/humbja para tatimit		46,505,102	30,569,599
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(7,446,146)	(4,618,916)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(7,446,146)	(4,618,916)
Fitimi/humbja e vitit		39,058,956	25,950,683
Te ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		39,058,956	25,950,683

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Albdesign PSP sh.p.k


Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000			7,947,691	8,047,691
Fitimi / Humbja e vitit				25,950,683	25,950,683
Lëvizjet përmes kapitalit		10,000	7,937,691	(7,947,691)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000	10,000	7,937,691	25,950,683	33,998,374
Fitimi / Humbja e vitit				39,058,956	39,058,956
Lëvizjet përmes kapitalit			25,950,683	(25,950,683)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	10,000	33,888,374	39,058,956	73,057,330

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 - 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori më 28 Mars 2018 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:


Z. Kleant Lami
Administrator


Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

ALBDESIGN PSP

Rr. Çerçiz Topulli, 17 - Kashar, Tiranë
NIPT: L518190050

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Palli "Binjaket",
No.5, 1000, Tiranë, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	39,058,956	25,950,683
Shpenzimet financiare jomonetare	11,557	7,460
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	2,604,889	544,519
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9,225,509	1,426,598
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Rezultati nga dalja e aktiveve afatgjata materiale	12,636	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(38,290,198)	(51,915,082)
Rënie/(rritje) në inventarë	(1,333,903)	3,861,923
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	55,387,215	69,761,410
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	140,293	30,080
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	66,816,954	49,667,591
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(13,104,252)	(32,653,619)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	23,467	-
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera	(25)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(13,080,810)	(32,653,619)
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Hua të arkëtuara	109,191	141,376
Pagesa e huave	-	(999,692)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	109,191	(858,316)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	53,845,335	16,155,656
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	21,318,714	5,170,827
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(11,557)	(7,769)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	75,152,492	21,318,714

4

Shënimet shpjeguese të faqeve 7 – 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

"Albdesign PSP" sh.p.k (Kompania) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë QKR me datë 19/06/2015 me NIPT L51819005Q në përputhje me Ligjin nr. 7638, date 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek (njëqindmijë) i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 lekë, me ortak të vetëm z. Elvis Sula.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është shitje shtypshkrime të ndryshme, punime grafike dhe dizenjime. Viti 2015 është viti i parë i aktivitetit të kompanisë. Aktiviteti i shoqërisë është parashikuar të jetë pa ndërprerje mbi 10 vjet.

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjia Mëzeze, Rruga "Çerçiz Topulli", Nr.17, Autostrada Tiranë-Durrës, Kashar, Tiranë.

Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L51819005Q.

Administratori i shoqërisë është z. Kleant Lami.

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 38 punonjës (2016: 36 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste, Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
EUR/LEK	132.95	135.23
USD/LEK	111.10	128.17
GBP/LEK	149.95	157.56

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot

e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çrregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çrregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën fillestare.

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlërësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlërësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm.

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Gjëndja e mjeteve monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	66,924,170	18,197,329
Llogari rrjedhëse	66,639,170	18,197,329
Fonde të ngurtësuara	285,000	-
Mjete monetare në arkë	8,228,322	3,121,385
	<u>75,152,492</u>	<u>21,318,714</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë vendas	74,640,577	75,555,290
	<u>74,640,577</u>	<u>75,555,290</u>

6. Llogaritë të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të arkëtueshme tregtare	26,426,240	82,320
Të tjera të arkëtueshme	25,457,229	2,000,000
	<u>51,883,469</u>	<u>2,082,320</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme afatshkurtra, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime doganore	106,494	82,058
Të tjera kërkesa për arkëtim	-	658,334
TVSH kreditore	1,013,176	7,056,657
Garanci për tendera	72,180	327,000
	<u>1,191,850</u>	<u>8,124,049</u>

8. Inventari

Gjëndja e inventarit, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Lëndë e parë	691,690	45,764
Mallra për rishitje	862,383	174,406
	<u>1,554,073</u>	<u>220,170</u>

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzime të shtyra, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime të shtyra	1,575,083	45,710
Parapagime për furnitorët	1,220,220	6,413,633
	<u>2,795,303</u>	<u>6,459,343</u>

10. Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

Përshkrimi	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Mobilije dhe orëndi	Kompjuter	Të tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	325,442	4,309,005		99,071	38,167	4,771,685
Shtesa	29,639,690	1,295,880	584,182	782,376	351,491	32,653,619
Pakësime						
Gjendja më 31 dhjetor 2016	29,965,132	5,604,885	584,182	881,447	389,658	37,425,304
Shtesa	11,386,244	465,000	109,970	298,616	844,422	13,104,252
Pakësime				45,208		45,208
Gjendja më 31 dhjetor 2017	41,351,376	6,069,885	694,152	1,134,855	1,234,080	50,484,348
Zhvlërësimi i akumuluar						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	10,848	143,634			2,544	157,026
Amortizimi i vitit	152,079	1,049,054	121,178	66,608	37,679	1,426,598
Gjendja më 31 dhjetor 2016	162,927	1,192,688	121,178	66,608	40,223	1,583,624
Amortizimi i vitit	7,770,466	882,435	115,082	269,852	187,674	9,225,509
Pakësime				9,106		9,106
Gjendja më 31 dhjetor 2017	7,933,393	2,075,123	236,260	327,354	227,897	10,800,027
Gjendja më 31 dhjetor 2015	314,594	4,165,371	0	99,071	35,623	4,614,659
Gjendja më 31 dhjetor 2016	29,802,205	4,412,197	463,004	814,839	349,435	35,841,680
Gjendja më 31 dhjetor 2017	33,417,983	3,994,762	457,892	807,501	1,006,183	39,684,321

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

11. Pjesmarrje në njësi të tjera

Shoqëria Albdesign PSP ka blere 24.5% kuota të kapitalit të Shoqërisë "Albanian Digital Printing Solutions and Services" sipas kontratës per Kalimin e Kuotave datë 20.04.2017, me vlerë 24.5 lekë.

12. Hua afatshkurtra

Hua-të afatashkurtra, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhejtor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Overdraft Karta Kreditit Raiffeisen	250,567	141,376
	<u>250,567</u>	<u>141,376</u>

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë vendas	55,563,124	106,770,759
Furnitorë të huaj	1,084,871	282,064
	<u>56,647,995</u>	<u>107,052,823</u>

14. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme tregtare	104,786,982	-
Të pagueshme të tjera	984,681	-
	<u>105,771,663</u>	<u>-</u>

15. Të pagueshme për shpenzime të konstatuara

Të pagueshme për shpenzime të konstatuara, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë për fatura të pa mbërritura	35,753	34,659
	<u>35,753</u>	<u>34,659</u>

16. Detyrime tatimore

Detyrime tatimore, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kontribute për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	286,468	250,597
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	24,966	19,279
Tatim në Burim	1,200,935	1,210,686
Tatim Fitimi	2,604,889	544,519
	<u>4,117,258</u>	<u>2,025,081</u>

17. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera, të cilat paraqesin detyrimet ndaj pononjësve dhe të tjera detyrime, më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime ndaj personelit	140,293	30,080
Të tjera detyrime	545,578	-
	<u>685,871</u>	<u>30,080</u>

18. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqesin financimet e ortakut dhe më 31 Dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Financim Elvis Sula	2,985,840	2,985,840
	<u>2,985,840</u>	<u>2,985,840</u>

19. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqërise është 100,000 Lekë (njëqind mijë lekë) i përbërë nga 1 kuotë me vlerë nominale 100,000 lekë, me ortak të vetëm z. Elvis Sula.

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e produkteve të gatshëm	161,312,259	164,495,547
Të ardhura nga kryerja e shërbimeve	66,632,522	6,399,138
Të ardhura nga shitja e mallrave	90,422,001	29,369,057
Të ardhura nga shitja e materialeve	12,808	437,481
	<u>318,379,590</u>	<u>200,701,223</u>

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Tabela më poshtë përfaqëson rakordimin e të ardhurave me deklaratimet mujore të TVSH-së.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Rakordimi ndërmjet të ardhurave në PASH dhe atyre të deklaruara në FDP	
Shitje total të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	318,419,832
Parapagime	(16,775)
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	318,403,057
Shitje produkte të gatshme	161,312,259
Shitje mallrash e materialesh	90,434,809
Shitje shërbime	66,632,522
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	23,467
Të ardhura të deklaruara në PASH që janë deklaruar shitje në FDP	318,403,057
Fitim nga këmbimet valutore	506,914
Të ardhura nga interesat	1,398
Të ardhurat të tjera financiare	17,934
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Fitimit	318,929,303

21. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera jo-kryesore dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e AQT-ve	23,467	-
Vlera Kontabël e Aktiveve të Shitura	(36,102)	
Fitime nga këmbimet valutore	506,914	86,905
Humbje nga këmbimet valutore	(355,048)	(54,441)
	139,231	32,464

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

22. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Tabela më poshtë përfaqëson një detajim të materialeve të para të konsumueshme dhe të shërbimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Kosto e lëndëve të para e materialeve	91,747,950	76,819,852
Nënkontraktorë	67,621,227	5,159,284
Kosto e mallrave	52,127,647	24,711,751
Qera trualli dhe ndërtesë	13,139,834	12,245,179
Mirëmbajtje dhe riparime makineritë dhe fabrika	3,972,278	834,769
Energji elektrike, ujë	3,442,122	-
Qera të tjera	1,126,993	94,000
Shërbime dhe shpenzime të tjera	209,710	52,600
Qera infrastrukturë prodhimi	-	11,435,912
	233,387,761	131,353,347

23. Të tjera shpenzime

Tabela më poshtë përfaqëson një detajim të shpenzimeve të tjera për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të tjera	2,404,049	352,796
Shpenzime udhëtimi dhe dieta	2,397,077	1,157,179
Konsulencë për shitje dhe asistencë teknike	1,600,000	18,391,680
Shërbime postare	1,525,248	842,431
Shërbim auditimi dhe konsulenca ekonomike	1,517,680	509,608
Liçenca printimi	903,289	-
Shpenzime administrative noteriale	747,461	777,113
Konsulenca juridike	688,829	-
Sponsorizim	600,000	-
Shpenzime për pjesmarrja në tender	458,976	764,537
Shpenzime për kontrolle teknike e çertifikime	402,150	800,076
Shpenzime trajnimi dhe rekrutimi	375,525	191,385
Komisione bankare	323,915	207,969
Shërbim ruajtje objekti	320,000	-
Prime të sigurimit	255,786	175,716
Taksa të ndryshme	209,313	197,000
Kancelari	144,232	162,408
Shpenzime për mirëmbajtje programe kompjuterike	89,695	59,647
Shpenzime përkthimi	82,450	556,866
Shpenzime për pritje	70,510	-
Leje mjedisi	67,500	30,000
	15,183,685	25,176,411

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

24. Shpenzime të personelit

Shpenzime të personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga dhe shpërblime	12,066,927	10,528,958
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetsore	1,951,406	1,675,239
	<u>14,018,333</u>	<u>12,204,197</u>

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime për gjoba dhe penaltete për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjoba dhe penaltete	55,500	
	<u>55,500</u>	<u>-</u>

26. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për interesa	(152,261)	(2,437)
Të ardhura nga interesat	1,398	724
Shpenzime të tjera financiare	(10,002)	-
Të ardhura të tjera financiare	17,934	-
Humbje nga këmbimet valutore nga huatë	-	(2,130)
Fitime nga këmbimet valutore nga huatë	-	308
	<u>(142,931)</u>	<u>(3,535)</u>

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	46,505,102	30,569,599
<i>Shpenzime të panjohura (si më poshtë):</i>	3,135,870	223,172
Shpenzime pritje dhe përcjellje	515,055	
Tatim në burim i paguar për furnitorin	274,852	23,879
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	55,500	
Produkte skarco	-	26,460
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	2,290,463	172,833
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>49,640,972</u>	<u>30,792,771</u>
	49,640,972	30,792,771
<i>Tatim fitimi @15%</i>	7,446,146	4,618,916
Fitimi i vitit	<u><u>39,058,956</u></u>	<u><u>25,950,683</u></u>

28. Palët e lidhura

Këto përfaqësojnë transaksionet me palët e lidhura, si njësitë e kontrolluara, të kontrolluara bashkarisht ose kanë një ndikim të konsiderueshëm nga palët e tilla. Politikat e tarifimit dhe kushtet e këtyre transaksioneve janë aprovuar nga manaxhimi.

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
<i>Të arkëtueshme nga palët e lidhura</i>		
Mag Utilities	8,949,311	2,082,320
Agi Kons	33,141,834	
Albdesign	5,479,936	
ADPS	4,312,388	
	<u>51,883,469</u>	<u>2,082,320</u>
<i>Të pagueshme ndaj palëve të lidhura</i>		
Mag Utilities	17,900,780	
Agi Kons	10,553,335	
Albdesign	77,149,595	
ADPS	167,953	
Orkaku Elvis Sula	2,985,840	2,985,840
	<u><u>108,757,503</u></u>	<u><u>2,985,840</u></u>

(Të gjitha vlerat janë në Lek)

28. Palët e lidhura (vazhdim)

Balancat me palët e lidhura të përfshira në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve paraqiten si me poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve		
<i>Shitje palëve të lidhura</i>		
MAG Utilities	583,312	68,600
Albdesign	35,255,440	
ADPS	15,800,117	
Agi Kons	2,088,269	
	53,727,138	68,600
 <i>Blerje nga palët e lidhura</i>		
Mag Utilities	33,261,361	
Albdesign	14,423,073	
ADPS	2,040,648	
Agi Kons	52,435,669	
	102,160,751	-

29. Angazhime dhe pasiguri**Çështje gjyqësore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

30. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit, e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.